



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr. 3587/Prot.
12

Gramsh, më 05. 12. 2023

V E N D I M

Nr. 67, datë 29 / 09 / 2023

PËR

DHËNIEN E DAKORTËSISË PËR VIJIMIN E PROÇEDURAVE TË HEQJES NGA
FONDI PYJOR/KULLOSOR PUBLIK PËR NDËRTIM DHE OPERIM TË HEC
“GRABOVA 1”, NGA SHOQËRIA “GRABOVA HYDROPOWER”shpk.

Këshilli Bashkiak Gramsh në mbledhjen e tij të datës 29.09.2023, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Mjedisit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbështetur në ligjin nr.139 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjin nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Ligjin nr.107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, në Ligjin nr.57/2020, datë 30.04.2020 “Për pyjet”, të Ligjit nr.9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullor” i ndryshuar, në Ligjin nr.10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive” të ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.888, datë 27.12.2022 “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacionit përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1374, datë 10.10.2008 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor”, në Udhëzimin e Ministrit Mjedisit nr.01, datë 08.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, Këshilli Bashkiak :

V E N D O S I :

1. Të shpreh dakortësinë për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor/kullor publik, për ndërtimin dhe operimin e Hec “Grabova 1” nga Shoqëria “GRABOVA HYEOPOWER”shpk të sipërfaqjes prej 0.1896 ha, në ngastrën pyjore nr.66 (0.147 ha për veprat e marrjes+dekantues dhe bazenin e presionit) të ekonomisë pyjore “Suhagorë-Mali i Grabovës” dhe në nënngastrën pyjore nr.97/b (0.0426 ha për ndërtimin e godinës së Hec “Grabova 1”) të ekonomisë pyjore “Dushku i Bulçarit” në territorin administrativ të Bashkisë Gramsh .

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Mjedisit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit si strukturë përgjegjëse për pyjet dhe kullotat pranë Bashkisë Gramsh.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETARI I KËSHILLIT

ENIS ZANI

